




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.kk.rks-gov.net; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Gjilanit, mbajtur më 30.6.2011 me këtë:

R E N D P U N E

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit,
2. Korniza afatmesme buxhetore 2012-2014,

Seanca filloi punimet në ora 10.20 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e seancës jashtëzakonshme ishin:

Anëtarët e Kuvendit
Drejtorët e drejtorive komunale
Përfaqësuesit e OSB-së
Përfaqësuesit e Njësisë për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut
Mediet

Seancën e jashtëzakonshme e hapi dhe kryesoi kryesuesi i Kuvendit i cili fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në sallë.

E kam të qartë se opozita, por ndoshta edhe pozita mund të kenë vërejtje pse kjo seancë nuk ka kaluar nëpër procedura të nevojshme, por për atë quhet edhe seancë e jashtëzakonshme, sepse kjo qarkore sot duhet të dorëzohet në MEF.

Ne duhet ta japim një vlerësim dhe nëse eventualisht bëjmë ndonjë ndryshim duhet ta aprovojmë.

Para se të fillojmë me pikën kërkoj nga sekretaria që të konstatojë prezencën e anëtarëve të Kuvendit në këtë seancë.

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në këtë seancë mungojnë: gjashtë (6) anëtarë të Kuvendit, Sabedin Kadriu, Elisah Ymeri, Enver Hajrullahu, Xhyzide Ismaili. Jashar Jashari dhe Selim Selimi

Izmi Zeka- është një numër i konsiderueshëm i anëtarëve që mungojnë, por për disa e di që kanë arsye, sepse ka filluar koha e pushimeve, por kuorum kemi dhe mund të vazhdojmë me punë.

2. Korniza afatmesme buxhetore 2012-2014,

Izmi Zeka- për këtë pikë të rendit të punës jemi në dijeni se është pak me vonesë, por për këtë as drejtorja nuk është fajtores, sepse ky është obligim i nivelit Qendror, prandaj e lus drejtorin e Drejtorisë së Financave për të na dhënë sqarime lidhur me këtë

Nuhi Nuhiu- përshëndetje për këshilltarët, drejtorët dhe mediet të cilët sot po e përcjellin këtë seancë të jashtëzakonshme.

Arsyet pse ka ardhur deri tek kjo seancë dhe deri në ditën e sotme për ta dorëzuar dhe të miratuar, kornizën afatmesme buxhetore qëndron në atë se qysh në maj ne e kemi marrë Qarkoren e parë buxhetore e cila është shumë e vonuar, sepse qarkoret buxhetore merren diku në muajin prill. Mirëpo ju e dini se e kemi pasur fushatë parazgjedhore e cila gjendje ka ndikuar që të vonohet qarkorja buxhetore.

Qeveria ka marrë qëndrim me Fondin Monetar Ndërkombëtar për këtë qarkore e cila në një mënyrë ka limituar dhe bërë përkufizimin e buxheteve komunale.

Grandi është një çështje të cilën ne nuk mund ta lëvizim si Komunë, por edhe tek të hyrat vetanake kemi problem për arsye se duhet dëshmi dhe fakte që ne t' i rrisim të hyrat vetanake. Ne vitin e kaluar i kemi tejkaluar të hyrat vetanake për 4%, por edhe këtë vit trendi është mjaft i mirë, por nuk na lejohet që ne të bëjmë një planifikim i cili do të na qet probleme gjatë realizmit.

Pas marrjes së qarkores ne e kemi mbajtur edhe mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, në të cilën mbledhje nuk kanë qenë të gjithë anëtarët.

Mirëpo ne kemi vazhduar edhe me një debat publik i cili është një hap ku dëgjohe zëri i qytetarit dhe jo zëri i zyrtarëve dhe drejtorive. Në atë dëgjim publik i kemi pasur disa kërkesa, por unë nuk kam qenë i kënaqur edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve, sepse te ne shumë pak vizitohet nga qytetarët Kuvendi dhe institucionet e tjera.

Në vijim të fjalës së tij z. Nuhiu dha shumë sqarime lidhur me këtë qarkore të cilën, anëtarët e Kuvendit e kanë pasur në material të seancës.

Sadudin Berisha- ne si grup i këshilltarëve dhe pse me një vonesë jashtëzakonisht të madhe e kemi marrë materialin i cili është desh të vijë me kohë dhe është e paraparë me rregullore sa ditë pune para ditës së mbajtje së takimeve duhet t' i u dorëzohet materiali këshilltarëve.

Së pari kemi të bëjmë me një pikë shumë të rëndësishme dhe më të rëndësishmen për Komunën e Gjilanit dhe qytetarët e Gjilanit, kemi të bëjmë me një buxhet që vendos shtyllat kryesore të zhvillimit dhe politikave ditore të Komunës për një periudhë kohore afatmesme tre vjeçare.

Mbajtja e në seance të jashtëzakonshme për të debatuar për një buxhet për një kornizë afatmesme buxhetore është me të vërtetë e pa përgjegjshme.

Seancat e jashtëzakonshme mund të thirren vetëm për çështje të jashtëzakonshme për derisa ko çështje është debatuar edhe në nivel të ministrisë dhe Qeverisë.

Së dyti afati i paraparë gjatë procedurave të cilat janë zbatuar deri më tash sërish janë në kundërshtim me çdo akt i cili është miratuar nga KK, edhe me Statutin edhe me rregulloren e punës. Ju lutem të mbahet debati publik për buxhetin tre vjeçar, para se të debatohet në trupat e zgjedhura nga qytetarët te Kuvendi i Komunës. I bindur jam se asnjë prej komiteteve komunale, nuk e ka pasur këtë projekt në diskutim, por edhe më pak Komiteti për Politikë dhe Financa. Është thirr debati publik, një ditë para se të mbahet debati, kjo është jashtëzakonisht jo serioze dhe kërkoj që mos të bie KK në këso situata. Ne e dimë se e kjo nuk është përfundimtare, por e dimë se kjo është shumë jo serioze mënyra se si ne i qasemi problemeve.

Së dyti drejtori i Drejtorisë theksoi kemi të bëjmë me një projekt afatmesëm jashtëzakonisht të varfër me mundësi të zhvillimit ekonomik dhe social të qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Ne i kemi dëgjuar të gjithë së bashku premtime e dhëna para 1.5 vite të cilat premtime as që figurojnë dhe as që ka shans teorike të bëhet një realizimi i programit të atyre premtimeve

Së dyti nga viti në vit nuk kemi asnjë ngritje buxhetore, veçmas te grandet.

Gjilani sërish mbetet zorrë qorre në tërë territorin e Kosovës. Shikoni infrastrukturën dhe mundësitë eventuale për t' u zhvilluar infrastruktura në Komunën e Gjilanit.

Në bazë të kësaj kornize shihet se kemi të bëjmë me një politikë më pak se sociale!

Nuk kemi asnjë mundësi të një zhvillimi të qëndrueshëm të premtuar nga partia në pushtet dhe besoj se është thënë para një viti e gjysmë në nëntor të viti 2009 se Gjilani do të ketë investime kapitale për një mandat 4 vjeçar mbi 100 milion euro .

Ne nuk flasim për ato shpenzime të cilat krijohen nga muaji në muaj për paga, mallra dhe shërbime të cilat edhe ato nuk e kanë një perspektivë. Me këtë buxhet mundësi eventuale për ngritjen e pagave punëtorëve të administratës, punëtorëve shëndetësor, të arsimit jo që është e limituar, por është e pa mundur të bëhet një lëvizje progresive duke parë standardin dhe ngritjen e çmimeve.

Në këtë kontekst duke e parë mos respektimin e procedurave mos konsultimi dhe marrja e mendimit të komiteteve profesionale të KK-së, mos konsultimi as me Këshillin e ekspertëve që nëse nuk gaboje vetëm dy herë është thirrur, prandaj kujtoj se komitetet, Këshilli i ekspertëve, drejtoritë dhe në fund Komiteti për Politikë dhe Financa është dashur ta rumbullakojnë aktivitetin e vet në një seancë të rregullt dhe jo në seancë të jashtëzakonshme.

Zijadin Maliqi- te ne është bërë praktikë që çdo vit të vijmë para aktit të kryer, sepse shqyrtimi i lëndëve patjetër duhet të bëhet sot, kurse vendimi të dorëzohet të nesërmen. Unë më tepër për këtë rast e fajësoi MEF-in, sepse i dërgon këto gjëra me shumë vonesë të madhe, kurse këto janë të parapara me ligjin mbi menaxhimin e financave që kanë afat të caktuar.

Fillimisht në këtë kornizë e kam parë se del Komuna e Artanës në vend të asaj të Gjilanit, prandaj patjetër duhet të përmirësohet.

Disa shënime që i dha drejtori, në këtë material nuk kam pasur mundësi t' i gjej, por unë jam bazuar në këtë material të cilin e kam marrë.

Në një fakt ku nuk mund të pajtohem është tek ajo që tek një pasqyrë ku është korniza afatmesme buxhetore 2012-2014, shihet se ka zvogëlim të investimeve kapitale nëpër vite, kurse drejtori e tha se kemi rritje të pagave dhe mëditjeve, por mua më ka penguar

se në anën tjetër kemi edhe rritje të mallrave dhe shërbimeve të cilat kanë mund të jenë më të vogla dhe të mos dëmtohen investimet kapitale.

Vetëm te buxheti i Shërbimit Civil Komunal ma merr mendja se është një buxhet i vogël për mallra dhe shërbime duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të punësuarve, shkollave, kurse te Shërbimi Civil është bukur i rritur.

Shihet kjo këtë vit ka qenë mbi 1 milion e 658 mijë, në 1 milion 762 mijë, kurse investime kapitale ulen. Diku vetëm për Shërbimin Civil Komunal janë mbi 837 mijë euro për mallra dhe shërbime e që janë shumë.

Te linja buxhetore ku është KK për mallra dhe shërbime, është një shumë simbolike në krahasim me të gjitha drejtorit dhe vijat e tjera, sepse janë paraparë vetëm 10 mijë euro për mallra dhe shërbime e cila shumë është e vogël, por kjo ka mundësi të rregullohet.

Ajo që më ka brengosur më së tepërmi është ndarja e grandeve nga MEF-i, ne asnjëherë nuk po informohemi nga drejtoria se si bëhet ndarja e grandeve komunale nga MEF-i.

Unë kam konstatuar se diçka nuk është në rregull me Komunën tonë, sepse kam hyrë në faqe elektronike të ministrisë dhe komunave dhe kam bërë disa krahasime me komunat përafërsisht të njëjta dhe nga shatë komuna kam konstatuar se prej shtatë komunave të cilat i kam nxjerr grandet, Komuna e Gjilanit merr grandin më të vogël.

Si shembull po e marr Ferizajn me të cilën Komunë përafërsisht jemi të njëjta, mirëpo Komuna e Gjilanit ka marrë grand mbi 14 milion, kurse Ferizaj mbi 16 milion e 400 mijë euro do të thotë për 2 milion euro Ferizaj ka marrë grand më shumë se Gjilani.

Në anën tjetër numrin e punëtorëve Gjilani e ka më të madh se Ferizaj, 2441 punëtorë të planifikuari ka Gjilani, 2373 Ferizaj. Për kokë të punëtorit Gjilani ka marrë 5890 euro, Ferizaj 6922 euro, kështu është edhe në komunat tjera deri te Prizreni i cili merr mbi 8097 euro për kokë të punëtorit.

Ne më shumë po i kushtojmë rëndësi të hyrave vetanake, por ato janë të hyra tona dhe nuk kemi pse të merremi me to, mirëpo nga kjo që po shihet komunat që po punojnë më tepër në tejkalim të hyrave vetanake po penalizohen.

Edhe përkitazi me këtë z. Maliqi dha fakte për disa komuna të cilat kanë pasur të hyra më pak, por edhe nuk e kanë realizuar planin, kurse në anën tjetër kanë përfituar më tepër grande. Unë propozoj që të mos merremi me të hyra vetanake, sepse po i rrisim këto të hyra, kurse në anën tjetër po penalizohemi nga MEF-i.

Duhet të bëhet përpjekje nga Drejtoria e Financave nga kryetari i cili nuk është sot i pranishëm, kurse është kryesori për buxhet, të bëjmë përpjekje ku qëndron puna pse Komuna e Gjilanit po mbetet me grande në këtë situatë që është. Komuna Gjilanit mbetet një ndër komunat më të dobëta dhe atë larg mbetet nga të tjerat se i përket grandeve.

Sokol Haziri – edhe unë i mbështesë vërejtje të cila t i dhanë parafolësit, sepse kjo është situatë jo shumë e qartë pse ne duhet vazhdimisht duhet të veprojmë në situata të jashtëzakonshme, kur ka mundësi që paraprakisht të planifikohen zhvillimet dhe kësaj çështje e cila është me shumë interes për Gjilanin t' i kishim kushtuar kujdes më të madh. Duhet planifikimet buxhetore, dihen zotimet, dihen datat dhe do të ishte mirë që herëve të tjera të përgatitemi për këto zhvillime. Sipas vlerësimit tonë ky kornizim afatmesme buxhetore, është kornizim i zhvillimit ekonomik për Gjilanin dhe në të vërtetë është dekonizimi i uljes së varfërisë dhe uljes së standardit të qytetarëve. Unë e kuptoj drejtorin i cili ishte shumë realist dhe më pëlqeu gjatë paraqitjes së tij, por nuk dua ta fajësoj askënd këtu me përjashtim të diskutimeve, dëgjimeve publike etj.

U tha nga parafolësit se ky region vazhdon të mbetet objekt më tepër i interesimeve parazgjedhore se sa objekt i zhvillimeve për të cilat duhet kushtuar një vëmendje të veçantë nga ana e qeverisë.

Nuk dua të bëj politikë, por këto janë brenga të qytetarëve dhe me këto parashikime buxhetore ne nuk dëshirojmë të fantazojmë diçka që do të arrihet diçka që ka qenë objektivë e premtuar zëshëm në Komunën e Gjilanit. Ndoshta do të duhej të dëgjohej zëri i qytetarëve të Gjilanit, sepse janë përmendur edhe hekurudhat për ndërtim.

Prandaj ne si AAK, për shkak të mungesës së komunikimit për shtresat e interesuara për këtë çështje me komunitetin profesional, me komunitetin e biznesit dhe të tjerat, nuk jemi të gatshëm që të shprehim mbështetjen lidhur me këtë çështje, sepse për një trup profesioniste muzikore të qytetit janë harxhuar seanca të tëra, janë harxhuar edhe aktivitete të tjera të shumta nga DKRS, kurse për atë çka është zhvillim dhe perspektivë e qytetit, mbahet një seancë e jashtëzakonshme e që për mua është e pakuptueshme.

Ejup Haziri- sa i përket çështjes që jemi duke e diskutuar u dhanë shumë vërejtje për të cilat mund të them se kanë vend. Prezantimin që e bëri drejtori, vërtetë e bëri si duhet. Ne politika nuk kemi çka të bëjmë por duhet të përpiqemi për të gjet zgjidhje dhe është e vërtetë ajo çka u tha këtu dhe shumë çështje më pëlqyen, por duhet shikuar në seancat e radhës për të bërë një deklaratë me të cilën të kërkohej nga Kuvendi i Kosovës për të pasur një trajtim më të mirë.

Një vërejtje të cilën e kam e të cilën e përmendi edhe Zijadini është çështja te organi më lartë i Komunës, te Kuvendi i cili ka vetëm 10 mijë euro për mallra dhe shërbime dhe është një nga organet i cili ka mbet në humnerë. Unë propozoj që edhe drejtori dhe kryesuesi, kryetari që të gjejnë mënyrën dhe kjo shumë të paktën të mbërrijë në 30 mijë euro, sepse KK nuk ka pasur mundësi të funksionojë ashtu siç i ka hije.

Arben Maliqi- drejtori e elaboroi këtë kornizë, por e elaboroi atë të cilën pat çka të elaborojë. Unë pajtohem me parafolësit e mi, sepse me të vërtetë duhet një elaborim më i gjerë, duhet një dëgjim më konciz. Neve gjithmonë na vijnë disa gjëra të ngutshme, mirëpo faji nuk është i drejtorit dhe nuk mund ta fajësoj drejtorin.

Shumëçka u fol, por më la mbresë një pyetje që e bëri z. Zijadin Maliqi pse Komuna e Gjilanit mbetet më e varfra?

Unë po i tregoj se Komuna e Gjilanit mbetet më e varfra dhe më e pambështetura nga niveli qendror, sepse pa marrë parasysh bindjen politike që e kemi ne e kemi votuar, ne ia kemi dhënë votat, liderëve, deputetëve dhe ministrave të regjioneve tjera.

Duhet vërë gishtin në kokë dhe të mendohet që duhet votuar për njerëzit tanë të cilët i kemi këtu !

Tahir Arifi- unë së pari e falënderoj z. Zijadin Maliqin për paraqitjen e tij shumë profesionale nga fjala e të cilët unë mësoj shumë. Ne të gjithë po pajtohem se procedurat gjer më këtu nuk kanë shkuar në rregull, por megjithatë ne jemi institucion komunal dhe kemi përgjegjësi para qytetarëve të Gjilanit.

Ne nuk i bëjmë politikat qeveritare, ato i bën qeveria dhe ato i kontrollon Kuvendi i Kosovës dhe nuk do të duhej këtu të merremi me ato gjëra dhe të bëjmë kritika nga ky pozicion, ministritë përkatëse ose kryeministrinë ose dike tjetër.

Ne do të duhej t' i kryenim detyrat tona, sepse ju e dini të gjithë qëndrimin e kryetarit të Komunës në raport me grandet dhe jam i bindur se ai atë qëndrim e ka përcjell edhe në qeveri. Mirëpo ne nëse flasim këtu askush nuk e dëgjon fjalën tonë edhe po ta kritikojmë

tërë ditën qeverinë. Ne e dimë se kemi përfaqësues në Kuvend të Kosovës është mirë që ata përfaqësues të cilët janë të zgjedhur ta krijojnë një grup dhe ata mund ta rregullojnë këtë punë të grandeve . Insistimi i jonë duhet të jetë të njerëzit e tanë të cilët i kemi zgjedhur atje dhe jo në këtë Kuvend t' i bëjmë politikë njëri tjetrit.

Tani jemi para një akti jo me fajin e drejtorit dhe institucioneve komunale, por kjo ka ardhë kështu, jashtë procedurave dhe unë e pata të qartë atë që e tha drejtori dhe Zijadin Maliqi dhe mendoj se ne duhet dhënë mbështetje në mënyrë që mos i pengojmë punën e institucioneve tona.

Nuhi Nuhiu- kur është fjala te Sadudin Berisha , diskutim, unë e thash shumë mirë nuk lejohet diskutimi, por vetëm dëgjimi. Duhet ta dalloni diskutimin dhe dëgjimin.

Në diskutim hape debate për projekte të ndryshme, kurse gjatë planifikimit të buxhetit ajo nuk lejohet. Dëgjimin e kemi mbajt, hapat janë respektuar. Ka qenë shumë mirë që këtë kornizë ta kemi në Kuvend para një muaji e jo ditën e fundit të qershorit.

Dikush e tha se duhet të analizohet dhe dëgjohet (Sokol Haziri), është shumë vërtetë, por kornizat afatmesme buxhetore ndryshojnë, prandaj ne e kemi pasur kornizën buxhetore 2011, 2012, 2013, por për shkak të decentralizmit, ajo kornizë afatmesme buxhetore nuk është zbatuar në tërësi.

Duhet ta keni të qartë se edhe kjo kornizë afatmesme do të ketë ndryshime.

Kjo kornizë sot aprovohet, kurse për ndryshimet për mallra dhe shërbime në KK, përsëri këtë do ta keni në Kuvend dhe ju merrni vendime, sa për mallra dhe sa për shërbime, komunalit etj.

Unë po e shoh se Zijadini po merret me çështje të grandit, mirëpo unë kam qenë inspektor në këtë Komunë me koeficient 6, kurse disa të tjerë me koeficient 7 në të njëjtin vend të punës, por kam tentuar që të barazohem, por kryeshefi më është përgjigj që kam gjet me 6 dha ashtu do të mbetesh.

Edhe çështja e grandit në fillim ka qenë me 6 dhe po vazhdojmë me 6.

Unë besoj se me regjistrimin e popullsisë kjo do të ndryshon te grandit, por me angazhimin e të gjithëve.

Unë si drejtor më pak mund të ndikoj në këtë çështje, por këtë lëvizje dhe ndryshim mund ta bëjnë deputetet tanë të cilët gjenden në Kuvendin e Kosovës.

Kjo kornizë duhet të miratohet, sepse nuk e ka bërë këtë kornizë Nuhi Nuhiu, as Qemajl Mustafa, por kjo ka ardh nga lartë nga MEF-i, FMN dhe kjo është dhe ky është kulaçi të cilin na e kanë ndarë.

Sadudin Berisha- mua më duket se drejtori po e ndërlikon termin në mes dëgjimit dhe diskutimit. Unë shumë qartë e thash diskutimi nuk është bërë në strukturat detyruese Kuvendare, as në komitete. Përveç drejtorive dhe komiteteve që ka qenë desh të informohen dhe të epet vlerësimi i tyre pavarësisht se kjo kornizë vije nga lart, sepse neve nuk mund të na kufizohet e drejta e gjykimit, sepse kemi të bëjmë me një buxhet të varfër dhe jo të një buxheti i cili është premtuar nga kjo qeveri se Gjilani do të jetë një Komunë e cila do të gëzojë investime kapitale me grande shumë më të larta.

Së dyti dëgjimi bëhet publik, por dëgjimi publik bëhet pasi të përfundojnë procedurat në strukturat tjera të komunës si janë komitetet dhe së fundi ai për Politikë dhe Financa, por ajo nuk ka ndodh dhe kemi të bëjmë tash vetëm me dëgjim publike dhe jo me diskutime. Sot ne po diskutojmë me një takim të jashtëzakonshëm dhe çështja e cila shtrihet për diskutim nuk mund të jetë çështje e jashtëzakonshme, por është çështje kryesore e cila duhet ta brengos çdo anëtarë të KK_së.

Shukrie Rapuca- z. drejtor iu dëgjova me vëmendje dhe i dëgjova edhe parafolësit e mi dhe është e vërtetë se këtu ka vërejtje dhe ka sugjerime të ndryshme. Mirëpo nuk do të merremi me asgjë tjetër përveçse do të merremi me një lëmi për të cilën duhet të jemi të shqetësuar për shifrat të cilat i shoh këtu të renditura.

Lista e projekteve të aprovuara për vitin 2011 është 76 mijë dhe vazhdojnë me 2012, 2013 për të cilin e përmendet një koeficient referues 6 dhe me 6 po të le. E ke gjet me 76 mijë e paske lënë me 80 mijë, kjo është vërtetë për shqetësim. Pasi që ne gjendemi në një pozitë të vështirë nuk dua të flas më shumë, por duke krahasuar cilësinë dhe të gjitha vetitë e kësaj lëmie është për shqetësim kjo shifër dhe duhet të dimë të gjithë se lëmia e bujqësisë është një lëmi që produktiviteti i saj, krejtësisht varet prej faktorit tjetër (zotit) dhe kisha pasur dëshirë që shuma e subvencionit a ka gjasa që të jetë e dedikuar për bujqësi diku rreth 100 mijë euro ose përndryshe do të jenë të zhgënjyer të gjithë ata që merren me këtë lëmi.

Riad Rashiti – unë nuk desha ta marrë fjalën, por më nxiti z. Drejtori i cili e akuzoi rëndë Komitetin për Politikë dhe Financa, por më duhet të përsëris edhe vërejtje e Sadudinit dhe të tjerëve, sepse ne në komitet jemi ftuar vetëm një ditë më herët dhe asnjë material dhe asnjë faqe nuk është përgatitur për një çështje e cila është e rëndësishme për Komunën tonë. Unë dua të them se ndoshta disa prej anëtarëve të komitetit nuk janë profesional në këtë lëmi, por e kam lexuar se si përgatitet një kornizë afatmesme dhe nuk po lëshohem në vërejtje në këtë përpilim, por nga Zijadini u përmend Komuna e Artanës dhe unë kam parë se është bërë një kopy paste nga komuna tjetër, por nuk po lëshohem në detale, por po lëshohem në një kontribut që edhe herëve tjera me sa unë e kam parë pjesë e kësaj kornize është pjesa e strategjisë zhvillimor për Komunën.

Përveç Drejtorisë për Bujqësi ku shihet se është punuar diçka, por te Drejtoria e Urbanizmit duhet të përgatitet një rregullore dhe të analizohet se ku është qyteti i Gjilanit me ndërtimet që janë pa leje, është mirë sepse Komuna e Gjilanit do të kishte mundësi që t' i rriste të hyrat vetanake për një shumë të konsiderueshme dhe do të bëhej një rregull në urbanizmin e qytetit.

Te Kadastru ka qenë desh të përfshihet identifikimi i tokës së uzurpuar, sepse e dimë se me vite ka qindra hektarë tokë të uzurpuar dhe është mirë këta të identifikohen, të bëhet një listë e tyre. Kjo nuk do të zgjidhet brenda një viti, por brenda 3-4 vite do të kishte marrë fund ky problem.

Unë mbështesë këtë kornizë

Arben Mehmeti – nuk kam se çka të shtoj përveç asaj që konstatuan shumica e diskutuesve se është një mospajtim i plotë me mënyrën se si ka ardhur ky dokument deri këtu. Ne në emër të LDK-së pasi që po thuhet kjo është vetëm formale dhe nëse nuk e aprovoni ju, kjo është çështje e kryer, mendoj se kjo është një jo seriozitet dhe kjo KK- në Gjilanit e qet para një sprove të rëndë, sepse ne po konsiderohemi vetëm si një instrument teknik. Për ta kthyer seriozitetin e këtij Kuvendi, unë propozoj që kjo çështje të shtyhet për një seancë të radhës. Ne jemi për të kaluar kjo kornizë buxhetore, por në këtë formë si ka ardhur në Kuvend nuk jemi. Më vjen mirë që edhe nga subjekti në pushtet pat vërejtje dhe në këtë pikë jemi në harmoni të përbashkët, prandaj është mirë që kjo të shtyhet dhe që ne të jemi pjesë e këtij vendimi të rëndësishëm për Komunën.

Zijadin Maliqi- unë kur e thash se është përmend Novo Bërda në vend të Komunës së Gjilanit, nuk e thash ndryshe, por Riadi e tha kopy paste, por unë nuk desha, sepse më erdhi inat , sepse po të ishte kjo nga një komunë e fortë disi isha pajtuar, por e thash që të bëhet përmirësimi.

Tjetra është se do t' i përgjigjem drejtorit. Mbrëmë kam hyr në faqe të MEF-it dhe i kam nxjerr disa shënime dhe e di që limitet vijnë nga lartë dhe nuk e kam që t' i bëj kritika drejtorit, por nuk qëndron ajo që nuk mund të ndryshohet dhe nuk qëndron ajo që e mori atë shembullin që e kemi gjet me një koeficient dhe ashtu ka mbet.

Ta marrin drejtori buxhetin e mëparshëm dhe ta bëjnë krahasimin me komuna, unë jam i bindur se Komuna e Gjilanit do të del më mirë, me çfarëdo kushti po deklaroj.

Në kohën e fundit është lënë Komuna e Gjilanit anash, por unë i kam nxjerr edhe formulat se si po bëhet kjo kornizë.

Është diçka në kundërshtim me numrin e punëtorëve të cilat fakte z. Maliqi i argumentoi me shifra.

Unë këtë po them se duhet bërë kërkesë, sepse është ende herët dhe tash janë limitet e para dhe duhet punuar në atë drejtim për t' i kërkuar grandet, sepse ato janë për neve dhe jo për mua.

Unë i kam thënë këto gjëra edhe vitin e kaluar edhe me rishikim si kemi qenë të shkelur, edhe atë shumë në krahasim me komunat e tjera.

Unë nuk e kam që të bëj kritika, por qëllimi im është që të përfitojmë diçka më shumë për Gjilanin.

Arben Maliqi- edhe unë jam i mendimit që shumica e KK- për mallra dhe shërbime duhet të rritet patjetër. Kam edhe një propozim që lista e projekteve për këtë vit është mirë të hiqet, të përfundojnë objekte të cilat kanë filluar, të mos mbesin në gjysmë dhe është mirë që të kryhen obligimet ndaj kompanive të ndryshme gjilanasë të cilat nuk ndihen mirë dhe janë para bankrotimit.

Izmi Zeka – dua edhe unë t' i them drejtorit se nëse është vetëm aspekt teknik për të kaluar në Kuvendit ne nuk e kalojmë fare dhe ia lëmë obligimet MEF-it.

Ta harrojnë edhe drejtori edhe të tjerët se kjo nuk është aspekt teknik, sepse pa kaluar në kuvend as në MEF dhe Qeveri nuk ia pranojnë. Duhet pasur kujdes, sepse edhe nëse nuk e aprovon ju ajo shkon, por nuk e marrin fare për bazë.

I pamë të gjitha procedurat si kanë shkuar, por ne në njëfarë forme e kemi këtë buxhet, por kjo nuk është as kuran as bibël që nuk mund të ndryshohet.

Ne e kemi obligim për ta kaluar sot, vërejtje t' i marrin drejtori dhe të ecim ë tutje.

Unë kërkoj nga të gjithë që ta votoni , prandaj kërkoj të deklaroheni kush është për!

Aprovohet korniza afatmesme buxhetore 2012-2014 me 17 vota për të anëtarëve të Kuvendit, kurse 12 ishin kundër, kurse 5 abstenime

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

Izmi ZEKA